

RAPORT I MONITORIMIT
KOMUNA E FERIZAJT
JANAR – QERSHOR 2012

Ky publikim është përkrahur nga National Endowment for Democracy



National Endowment *for* Democracy
Supporting freedom around the world

Copyright © 2012, Iniciativa për Progres – INPO

INPO ka të gjitha të drejtat e rezervuara për këtë botim. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo shpërndahet në çfarëdo forme të mundshme pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

Qëndrimet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi vetëm e botuesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen se përfaqësojnë qëndrimet e donatorit të këtij botimi.

Përmbajtja

1. HYRJE.....	4
2. PËRMBLEDHJE	5
3. METODOLOGJIA	7
4. RESPEKTIMI I PARIMEVE TË QEVERISJES SË MIRË	8
TRANSPARENCA.....	9
INFORMIMI PUBLIK.....	9
LLOGARIDHËNIA	10
QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE.....	12
PJESËMARRJA PUBLIKE.....	13
DËGJIMET PUBLIKE	14
5. EFIKASITETI I DREJTORIVE.....	14
6. EFIKASITETI I BASHKËSIVE LOKALE.....	18
7. ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË FERIZAJT 20	
RAUNDI I PARË I ZGJEDHJEVE	20
RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE.....	22
8. KUVENDI KOMUNAL - VENDIMET	23
FUNKSIONIMI I KPF-SË.....	25
MARRDHËNIET E EKZEKUTIVIT ME LEGJISLATIVIN.....	26
NDËRMARRJET PUBLIKE KOMUNALE.....	26
10. ZHVILLIMI URBAN NË KOMUNËN E FERIZAJT.....	28
11. ARSIMI.....	29
TESTI KOMBËTAR DHE CILËSIA E TIJ	30
TESTI I ARRITSHMËRISË.....	31
ÇERDHET	31
KULTURA.....	32
12. REKOMANDIME	32

1. HYRJE

Komuna është njësi bazë e Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Kosovës. Qeverisja e Komunave të Kosovës bëhet nëpërmjet Ligjit që mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe gjithnjë duke respektuar parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, komunat e Kosovës gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes dhe kryejnë të gjitha veprimtaritë që janë të interesit të përgjithshëm lokal e që nuk janë të rezervuara për pushtetin Qendror.

Për funksionim efikas të çdo shoqërie demokratike nuk mund të flitet nëse nuk ka ndërveprim dhe veprime të përbashkëta mes qytetarëve dhe pushtetit lokal. Veprimi i përbashkët i pushtetit lokal dhe qytetarëve nuk është vetëm supozim për udhëheqje të suksesshme me komunën, por është edhe parakusht ligjor për avancimin e demokracisë së drejtpërdrejtë, përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve në komunë.

Politikat që i bënë komuna e Ferizajt dhe vendimet që i merr prekin interesat e një numri të madh të qytetarëve, për më tepër Komuna e Ferizajt menaxhon një buxhet mjaftë të madh në vlerë prej 19 milion Euro. Duke pasur parasysh se komuna ekziston që t'iu përgjigjet interesave dhe t'ju shërbej nevojave të qytetarëve dhe se menaxhimi i mirë me komunën nuk është proces i lehtë, komuna e Ferizajt si njëra prej shtatë njësive më të mëdha dhe më të rëndësishme të Vetëqeverisjes Lokale në Kosovë, luan një rol mjaftë të rëndësishëm për vlerësimin e suksesit të qeverisjes lokale në Kosovë.

Mirëpo edhe me gjithë këtë rol me rëndësi dhe obligime të komunës ndaj qytetarëve edhe më tutje Komuna e Ferizajt vazhdon të përballlet më probleme të ndryshme si: me mos përmbushjen e kërkesave të qytetarëve, pjesëmarrjen e ulët të qytetarëve në vendimmarrje, menaxhim jo të mirë më buxhetin, transparenca dhe llogaridhënia nuk përfillen nga disa zyrtarë komunal që si rezultat fajësohet e tërë komuna nga publiku, kurse edhe ato pak tubime publike që organizohen mbahen për qëllime fushatash, madje ka edhe raste kur në dëgjimet publike vjen vetëm një qytetarë.

Më qëllim të adresimit të këtyre problemeve dhe promovimit të vlerave të institucioneve transparente e llogaridhënese, Iniciativa për progres - (INPO) më mbështetjen e fondacionit National Endowment for Democracy (NED), ka lansuar projektin “Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në komunën e Ferizajt”. Përmes këtij projekti synohen që të arrihen këto objektiva:

1. Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies në komunat jug – lindore të Kosovës;

2. Rritja e pjesëmarrjes së grupeve të marginalizuara të shoqërisë në proceset vendimmarrëse;
3. Informimin dhe inkurajimin e aktivizimit qytetar në lidhje me zhvillimet në komunë;
4. Rritja e bashkëpunimit ndërkomunal në mes komunave jug – lindore të Kosovës.

Ky raport përfshin periudhën Janar – Qershor 2012.

2. PËRMBLEDHJE

Raporti i monitorimit për Komunën e Ferizajt pasqyron gjetjet kryesore, analizat dhe rekomandimet e dala nga procesi i monitorimit të punës së komunës së Ferizajt. Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar nga afër të gjitha segmentet e punës së administratës komunale duke filluar që nga puna e drejtorive, zgjedhjet për kryetarin, puna e kuvendit komunal e deri tek puna e ndërmarrjeve publike.

Duke qenë një gjashtëmujor i dy sfidave të mëdha të asaj të emergjencës për shkak të motit të ligë si dhe të zgjedhjeve të jashtëzakonshme të përcjellura me vonesat e aprovimit të buxhetit, INPO ka vlerësuar se performanca e qeverisjes lokale në këtë periudhë ka pasur një rënie në shumë parametra të saj. E përqendruar në procesin zgjedhor qeveria komunale ka lejuar të krijohen boshllëqe në punën e saj që është reflektuar në një situatë ku gjatë kësaj periudhe është shfrytëzuar vetëm 33 përqind e buxhetit, ndërkaq ngecje të mëdha janë shënuar edhe në shfrytëzimin investimeve kapitale. Në anën tjetër kemi pasur një paralizë të kuvendit komunal, gjë që është reflektuar drejtpërdrejtë në interesin e qytetarëve.

Sa i përket respektimit të parimeve të qeverisjes së mirë INPO vlerëson se komuna e Ferizajt ka shënuar progres të përzier. Zyra përgjegjëse për informim në mënyrë të rregullt ka njoftuar publikun për mbajtjen e mbledhjeve brenda afatit ligjor. Institucionet komunale kanë shënuar progres sa i përket llogaridhënies administrative, por jo të gjithë drejtorët e drejtorive komunale kanë qenë të pranishëm në mbledhjet e KPF-së për t'i dhënë sqarimet e nevojshme këshilltarëve komunal si dhe gjatë mbledhjeve të kuvendit komunal jo të gjithë drejtorët kanë përgatitur materialet e nevojshme dhe ia kanë dorëzuar paraprakisht këshilltarëve komunal si dhe i janë përgjigjur pyetjeve që këshilltarët komunal i kanë pasur gjatë mbledhjeve në lidhje me veprimtarinë e drejtorive.

Komuna e Ferizajt për këtë gjashtëmujor ka pranuar gjithsej 13 kërkesa për qasje në dokumente publike. Prej 13 kërkesave të pranuar, 9 prej tyre kanë marr përgjigje pozitive, 1 kërkesë është akoma në proces e sipër, kurse 3 janë refuzuar. Për INPO-n janë shqetësuese arsyet e refuzimit të kërkesave, siq ishte rasti me refuzimin e kërkesës së INPO-s për qasje në qasje në Raportin për gjendjen mjedisore të komunës të vitit 2010 dhe 2011. Kërkesa e INPO-s është refuzuar me arsyetimin se Plani lokal i veprimit në mjedis është publikuar në web-faqen e komunës. Por

INPO vlerëson se arsyetimi ishte i pabazë dhe nuk kishte të bëjë me dokumentin të cilin INPO e ka kërkuar.

Të gjeturat e INPO-s edhe për funksionimin e shumicës së drejtorive komunale flasin për një mospërbushje të detyrave, duke lënë shumëçka për të dëshiruar si në aspektin e transparencës ashtu edhe të llogaridhënies. Edhe funksionimi i bashkësive lokale nuk është i kënaqshëm zyrat e gjendjes civile nuk po funksionojnë siç duhet dhe po e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kushte jo adekuate për punë.

INPO gjatë kësaj periudhe ka monitoruar tërë procesin zgjedhor dhe me kohë ka paraqitur të gjitha vërejtjet e saja të bëra publike në raportet e veçanta e disa prej tyre janë përfshirë edhe në këtë raport. Përkundër rrjedhës së qetë të zgjedhjeve INPO ka shënuar shumë defekte në proces dhe konkludon se mbeten shumë detyra për organet gjegjëse për t'i evituar ato për të pasur një sistem sa më të përsosur zgjedhor.

Edhe KPF nuk ka arrit të kryej funksionin vet siq duhet pasi që gjatë fushatës zgjedhore ka pauzuar. INPO ka vërejtur se ky pauzim ka qenë i panevojshëm dhe krejtësisht i dëmshëm, sepse përkundër mungesës së kryetarit, KPF-ja dhe KK-ja kanë mundur t'i kryejnë punët e tyre dhe të mos vije deri te një stagnim institucional. Po ashtu për shkak të kalimit të anëtarit të këtij Komiteti nga radhët e LDK-së, Avdullah Hoxhës në radhët e PDK-së, nuk janë gjetur dhe as shfrytëzuar rrugët ligjore për zëvendësimin dhe kompletimin sa më të shpejt të Komitetit me anëtar të ri. Gjatë kësaj kohe janë marrë shumë vendime në KPF me një mbizotërim të plotë të pozitës.

Sa i përket mardhënieve mes ekzekutivit dhe legjislativit, bazuar në funksionimin kuvendit komunal dhe nga prizmi i këtyre raporteve INPO konstaton se ende kuvendi shikohet vetëm si vendi ku duhet ngritur gishtat për çështjet që propozon ekzekutivi dhe jo si vendi ku edhe të lindin politikat. Roli i këshilltarëve komunal është rrudhur deri në masën që ata nuk janë më subjekt krijues, aktiv por për më shumë janë objekte dhe numra. Po thuaj asnjë nga rregulloret dhe pikat e rendit nuk propozohen nga këshilltarët por vetëm nga KPF-ja e cila punon në ndikimin e drejtorive dhe të kryetarit.

Përmbledhja e rekomandimeve kryesore :

1. Rekomandojmë që pushteti lokal të krijojë plane operative për situatat urgjente; vonesën e aprovimit të buxheti; situatat emergjente të shkaktuara nga natyra si dhe gjatë zgjedhjeve të imponuara të jashtëzakonshme.
2. INPO ka konstatuar rënien e performancës qeverisjes gjatë zgjedhjeve andaj rekomandon që me kusht që të mos përsëriten këto dobësi që qeveria lokale të mbetet sa më larg këtyre zhvillimeve dhe të vazhdon t'i përmbush detyrat e saj ligjore.

3. Rekomandohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa që ndryshimet që prekin rrjedhat buxhetore të mos i bëjë në procedurë ad – hoc por ajo të jetë pjesë e strategjive buxhetore afatgjata dhe pjesë e komunikimeve të gjera.
4. Raportet mes Ekzekutivit dhe Legjislativit rekomandohet të marrin kualitet të ri ku duhet të fuqizohet roli i Kuvendit dhe i Këshilltarëve komunal.
5. Rekomandojmë që Drejtoria e Arsimit të bëjë analizë dinamike të suksesit të maturantëve ferizajas në procesin e regjistrimit në fakultete dhe nga aty për nxjerr rekomandime për avancimin procesit arsimor në komunën tonë
6. Mbetet detyrë e përhershme e komunës të fuqizojë ndikimin e vet te ndërmarrjet publike për t'i përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve.

Duke shprehur përcaktimin tonë që të punojmë një raport sa më objektiv dhe sa më analitik, shpresojmë që ky raport të mirëpritet dhe të pranohet si një vërejtje publike për t'i përmirësuar qasjen dhe pëmbushjen e detyrave ligjore nga pushteti lokal.

3. METODOLOGJIA

Në kuadër të programit për qeverisje të mirë dhe realizimin e objektivave të parapara me projektin për “Promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në Kosovën Juglindore”, INPO ka parashikuar një varg aktivitete për t'u implementuar. Këto aktivitete mund të përmbliken në aktivitete për promovimin e transparencës, komunikimit dhe llogaridhënies së komunës ndaj qytetarëve dhe monitorimin e drejtpërdrejtë të punës së organeve komunale, ku përfshihen ekzekutivi, i cili udhëhiqet nga Kryetari i komunës dhe Asambleja Komunale dhe komitetet e saj.

Hartimi i këtij raporti është bërë duke përdorur metodën kuantitative, elemente të metodës kualitative dhe metodës krahasuese. Raporti bazohet në një analizë të thellë të dokumenteve relevante, përfshirë këtu legjislacionin aktual që rregullon veprimtarinë e komunave, buxhetet vjetore dhe raportet e ndryshme financiare, projektet kapitale, statutin e komunës së Ferizajt, rregulloret që ka nxjerr kuvendi komunal i Ferizajt, intervistat me drejtorët e drejtorive të komunës dhe personelin në përgjithësi.

Për më tepër tashmë INPO ka zhvilluar edhe metodologjinë e vet të monitorimit të komunave, ku ka të angazhuar monitorues, detyra e të cilëve është që të monitorojnë aktivitetin dhe efikasitetin e punës së ekzekutivit të komunës dhe asamblesë komunale në kuadër të parimeve të qeverisjes së mirë. Kështu që të dhënat që janë mbledhur nga raportet e monitorimit shërbejnë si të dhëna primare për hartimin e këtij raporti.

Në bazë të metodologjisë së monitorimit, INPO monitoron këto aspekte të qeverisjes lokale në Ferizaj:

- Mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të tij (KPF dhe KPK)
- Aktivitetet e ekzekutivit të komunës së Ferizajt
- Përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje

Periodha për të cilën raportohet përfshinë periudhën Janar - Qershor 2012.

4. RESPEKTIMI I PARIMEVE TË QEVERISJES SË MIRË

Qeverisja e mirë mbështetet në gjashtë parime kryesore¹, ku ndër parimet udhëheqëse janë: transparencja, pjesëmarrja publike, llogaridhënia dhe secila prej këtyre parimeve mbështetet në mekanizma shtesë që ndihmojnë arritjen e tyre. Transparencja në nivelin lokal është paraqitur si mekanizëm që mundëson që informatat e bollshme mbi punën e qeverisë lokale të jenë në dispozicion dhe me qasje të lehtë për popullatën, t'iu ndihmojë autoriteteve lokale që të ushtrojnë veprimtarinë e tyre të hapur ndaj publikut dhe të jenë të përgjegjshëm në kryerjen e aktiviteteve të tyre të përditshme. Për më tepër transparencja është forcë shtytëse për ndërtimin e një qeverisje të mirë dhe demokratike, kështu që i kontribuon promovimit të zhvillimit lokal, rritjes ekonomike dhe kohezionit social.

Pjesëmarrja publike nënkupton një proces të vazhdueshëm dhe të hapur të bashkëpunimit ndërmjet qeverisë dhe popullatës në planifikimin dhe zbatimin e misionit të komunës dhe komponentëve të ndryshme të saj. Pjesëmarrja publike është mekanizëm për fuqizimin e rolit të qytetarëve në vendimmarrje, bashkësive të biznesit, shoqërisë civile dhe palëve të interesuara. Thelbi i pjesëmarrjes publike është që kur komuna synon të nxjerrë një vendim ose të hartoj një plan që i prek interesat e qytetarëve atëherë publiku duhet të informohet për atë vendim ose plan. Edhe pse pjesëmarrja publike është një e drejtë civile dhe jo obligim, qytetarët duhet të inkurajohen që të marrin pjesë në qeverisje dhe të vihen në dijeni për të drejtat e tyre nga udhëheqësia komunale, pasi që “pjesëmarrja e vazhdueshme e qytetarëve në procesin politik i kontribuon punës së hapur dhe transparente të pushtetit ekzekutiv dhe përfaqësues.”²

Llogaridhënia është procesi i pranimit të përgjegjësisë, që i është besuar zyrtarit komunal qoftë me ligj ose kontratë, në emër ose në interes të komunës dhe qytetarëve.³ Me fjalë tjera llogaridhënia është obligimi i qeverisë që të respektojë interesat e atyre që preken nga vendimet, programet dhe intervenimet e saj përmes mekanizmave për reagim dhe zbatim. Në realitet, llogaridhënia shpjegon për qytetarët se çfarë bënë komuna, si e bënë dhe pse e bënë.

¹ Principles of Good governance http://www.cipfa.org.uk/pt/download/governance_standard.pdf (Qasur në qershor 2012)

² Citizens' participation in the process of preparation and implementation of laws and other public policy instruments http://www.ecnl.org/dindocuments/274_Brochure%20on%20citizen%20participation%20ENG.pdf (Qasur në qershor 2012)

³ Ministria e administrimit të pushtetit lokal (2009): Transparencja lokale dhe pjesëmarrja publike. Prishtinë

Llogaridhënia arrihet vetëm pasi zyrtarët komunal ta njohin qytetarin si punëdhënës të tyre dhe të pranojnë se ata i shërbejnë vullnetit të tyre.

TRANSPARENCA

Transparenca është mekanizmi më i rëndësishëm për një sistem të qeverisjes efektive, duke respektuar këtë mekanizëm qeveria lokale i bënë publike aktivitetet e saj, dokumentet dhe qëndrimet e saj për çështjet e ndryshme. Qeveri lokale transparente konsiderohet ajo qeveri që është e hapur për publikun, komunikon me qytetarët, është llogaridhënese dhe ushtron veprimtarinë e saj me përgjegjshmëri.

Elementet më të rëndësishme të transparencës përfshijnë: takime të hapura me qytetarë, paraqitje financiare, qasje në informacion, prokurim i drejtë, publikim i të hyrave të Kryetarit, drejtorëve, kryesuesit të kuvendit dhe anëtarëve të kuvendit, punësim i personelit në mënyrë të ligjshme dhe të hapur etj. Për më tepër, si masa plotësuese për transparencën llogariten edhe integriteti dhe etika publike, masat kundër korrupsionit dhe luftimi i konfliktit të interesit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacioni mbi qeverisjen lokale i obligon komunat e Kosovës që të plotësojnë kriteret, të hartojnë politika dhe praktika të mira që e fuqizojnë transparencën.⁴ Më tej, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale u kërkon komunave që të funksionojnë në mënyrë transparente, të mbajnë takime publike dhe të këshillohen me qytetarët, t'i publikojnë aktet e tyre, t'u përgjigjen kërkesave dhe peticioneve të qytetarëve. Veçanërisht LVL specifikon se Kuvendi Komunal duhet të miratoj rregullore komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës duke rritur kështu pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe duke lehtësuar qasjen në dokumentet zyrtare të komunës.⁵

Mungesa e transparencës në nivel lokal ka prekur shumë fusha të jetës, pothuajse në çdo vend. Keqpërdorimi i funksioneve dhe përgjegjësi nga punëtorët komunal, lëshimi i dokumenteve të paqarta, veçanërisht atyre financiare që nuk premtojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve, ofrimi i privilegjeve për njerëzit që janë të lidhur me pushtetin, dhe aktivitetet tjera të pazakonshme janë disa prej aspekteve që flasin për mungesë të transparencës në komunën e Ferizajt. Kjo qeverisje lokale, ku qytetari nuk dëgjohet dhe as nuk pyetet, lë shumë për të nënkuptuar se korrupsioni dhe dukuritë tjera negative janë të pranishme dhe këtë fakt po e vërteton çdo vit edhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në raportet e saj.⁶ Pasi që është e vështirë që transparenca të zbatohet në mënyrë krejtësisht të pastër pa i përdorur mekanizmat shtesë, më poshtë shohim se sa i ka respektuar komuna e Ferizajt disa prej këtyre mekanizmave.

INFORMIMI PUBLIK

Para së gjithash transparenca ka të bëjë me qasjen në informata, ngase nëse pushteti lokal i kryen punët e veta në fshehtësi dhe larg syrit të publikut, atëherë pa dyshim se bëhet objekt i akuzave

⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 123.

⁵ Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 68.

⁶ Raporti i auditimit 2012 për pasqyrat vjetore financiare të komunës së Ferizajt vlerëson që komuna e Ferizajt me gjithë performancën e mirë në shpenzimin e buxhetit duhet të sigurojë raportime të besueshme financiare dhe të shtrijë sistemin e llogaridhënies në të gjitha nivelet e komunës.

publike për keq menaxhim, zhvatje të parasë publike dhe korrupsion. Pra supozimi i parë i një qeverie lokale transparente është informimi i publikut.

Komuna e Ferizajt gjatë periudhës janar-qershor 2012 në përputhje me ligjet në fuqi dhe veçanërisht me udhëzimin administrativ nr. 2008/09 për transparencën në komuna⁷, ka mbajtur mbledhjet e kuvendit të komunës dhe të komiteteve të tij të hapura për publikun, përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe shoqërisë civile. Kryesuesi i kuvendit të komunës nëpërmjet zyrës përgjegjëse për informim, në mënyrë të rregullt ka njoftuar publikun të paktën 7 ditë para mbajtjes së mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë para mbajtjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme.

Gjithashtu njoftimet për mbledhjet e kuvendit komunal janë bërë edhe përmes shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës, në mediat e shkruara dhe elektronike dhe në ueb-faqen e komunës. Përveç njoftimeve për takimet publike, komuna e Ferizajt në disa raste ka njoftuar qytetarët edhe për planet, veprimet dhe programet e rëndësishme me interes publik.⁸ Në takimet publike që janë mbajtur, kanë marrë pjesë zyrtarët më të lartë komunal dhe të gjithë zyrtarët kompetent për çështjet që janë diskutuar, në përputhje me nenin 97 të statutit të Komunës së Ferizajt dhe udhëzimin administrativ të MAPL-së 2008/09.

Mirëpo me gjithë përpjekjet e komunës së Ferizajt për t'i informuar qytetarët, siç duket informimi i publikut nuk po e arrin efektin e duhur pasi që qytetarët nuk po i përgjigjen njoftimeve të komunës me pjesëmarrjen e tyre. Edhe pse komuna i kryen obligimet e veta ligjore duke e njoftuar publikun për mbajtjen e takimeve publike dhe çështjeve tjera me interes publik kjo nuk po rezulton me sukses dhe kurrsesi nuk duhet të kuptohet si përmbushje e përgjegjësisë nga komuna dhe se pjesëmarrja e qytetarëve është e drejtë civile, kurse komuna nuk mund ta detyrojë askënd që të marr pjesë në aktivitetet e komunës. Komuna duhet domosdoshmërisht të ketë mënyra dhe mjete me të cilat e kupton mendimin e qytetarëve, me qëllim që t'i realizoj veprimet dhe aktivitetet e saj në përputhje me mendimin e qytetarëve, pasi që përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje është ndër parimet themelore të qeverisjes demokratike dhe njëherit edhe obligim ligjor.⁹

LLOGARIDHËNIA

Llogaridhënia është një term shumë i vështirë për t'u definuar, pasi që për njerëz të ndryshëm ka kuptime të ndryshme. Në thelb llogaridhënia është procesi i pranimit të përgjegjësisë për veprimet që bëjnë komuna dhe gatishmëria për t'u përgjigjur për ato veprime.¹⁰ Llogaridhënia

⁷ Udhëzimi administrativ është i disponueshëm në <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/0f8d2612-8259-43ad-828c-dda2cc3fc318/UA-Nr--2008-09-Per-transparence-ne-Komuna.aspx> (Qasur në qershor 2012)

⁸ Komuna e Ferizajt njofton qytetarët, bletarët dhe policinë e Kosovës për fillimin e implementimit të projektit për dezinfektimin hapsinor në territorin e qytetit të Ferizajt. Shih njoftimin e datës 12 qershor 2012, i disponueshëm në [http://kk.rks-gov.net/ferizaj/News/Njoftim-\(2\).aspx](http://kk.rks-gov.net/ferizaj/News/Njoftim-(2).aspx)

⁹ Në bazë të parimit të subsidiaritetit vendimet e qeverisë lokale duhet të merren sa më afër qytetarëve.

¹⁰ Këto ishin përfundimet që dolën nga konferenca vjetore e grupit evropian për administratën publike që u mbajt në Ljubljana, me temë *llogaridhënia në qeverisjen lokale*. Për më shumë shih publikimin që është i disponueshëm në http://soc.kuleuven.be/io/egpa/fin/paper/slov2004/Farneti_Bestebreur.pdf (Qasur në korrik 2012)

mund të jetë e trefishtë: administrative, politike dhe financiare.¹¹ Llogaridhënia administrative nënkupton se zyrtarët komunal duhet t'i zbatojnë në mënyrë strikte obligimet ligjore, të jenë përgjegjës ndaj këshilltarëve komunal dhe anasjelltas si dhe i obligon zyrtarët komunal qofshin të zgjedhur apo të emëruar të janë të përgjegjshëm ndaj qytetarëve.

INPO gjatë kësaj periudhe të monitorimit ka vërejtur se jo të gjithë drejtorët e drejtorive komunale kanë qenë të pranishëm në mbledhjet e KPF-së për t'i dhënë sqarimet e nevojshme këshilltarëve komunal si dhe gjatë mbledhjeve të kuvendit komunal jo të gjithë drejtorët kanë përgatitur materialet e nevojshme dhe ia kanë dorëzuar paraprakisht këshilltarëve komunal si dhe i janë përgjigjur pyetjeve që këshilltarët komunal i kanë pasur gjatë mbledhjeve në lidhje me veprimtarinë e drejtorive. Sa i përket kësaj çështjeje nga opozita adresohen shumë kritika ndaj papërgjegjësisë së disa nga drejtorëve të drejtorive për raportim korrekt dhe me kohë në Kuvendin Komunal.

Duke pasur parasysh vetëdijesimin e qytetarëve vitet e fundit lidhur me rëndësinë e procedurave ligjore dhe respektimin e ligjit në përgjithësi, drejtoritë e komunës janë mjaftë të frekuentuara nga qytetarët gjatë ditës. Numër i madh i qytetarëve takohen me drejtorët e drejtorive komunale dhe kërkojnë prej tyre ndihmë dhe sqarime. Kurse një praktikë e re në përgjigjen e kërkesave që qytetarët i kanë për drejtoritë e caktuara është edhe komunikimi me e - mail. Sipas drejtoreshës së urbanizmit, xheodezisë dhe kadastrit, Qazime Vatës ka pasur raste edhe kur qytetarët kanë kërkuar sqarime përmes e - mail-it nga drejtorja e urbanizmit lidhur me pronën e tyre, zonat urbane dhe drejtorja iu ka kthyer përgjigje përmes email-it.¹²

INPO duke pasur parasysh aktivitetin e komunës së Ferizajt gjatë kësaj periudhe kohore konstaton se komuna e Ferizajt ka shënuar progres sa i përket llogaridhënies administrative.¹³ Në përgjithësi zyrtarët komunal i janë përgjigjur pyetjeve dhe kërkesave të këshilltarëve komunal dhe janë treguar të përgjegjshëm në ushtrimin e detyrës së tyre në raport me qytetarët dhe shoqërinë civile.

Sa i përket llogaridhënies financiare, Drejtorja për ekonomi, buxhet dhe financa ka raportuar rregullisht kryetarit të komunës, ka qenë vazhdimisht pjesë e KPF-së dhe ka marr pjesë në diskutimet e kuvendit komunal lidhur me ndarjen dhe shpenzimin e fondeve publike. Pra raportimi financiar ka qenë konform legjislacionit por vazhdimisht ka pasur vërejtje dhe sugjerime nga ana e anëtarëve të Kuvendit, sidomos tek kategoria e shpenzimeve darka dhe dreka zyrtare, naftë dhe derivate të tjera.

¹¹ Ministria e administrimit të pushtetit lokal (2009): Transparenca lokale dhe pjesëmarrja publike. Prishtinë , fq. 44.

¹² Intervistë me Qazime Vatën Drejtoreshë e urbanizmit, gjeodezisë dhe kadastrit në komunën e Ferizajt.

¹³ Llogaridhënia administrative nënkupton se zyrtarët komunal duhet t'i zbatojnë obligimet dhe procedurat ligjore, të jenë përgjegjës ndaj këshilltarëve komunal dhe ndaj qytetarëve.

INPO vlerëson se komuna e Ferizajt ka respektuar standardet ligjore mbi raportimin financiar por është shqetësues fakti se nuk ka arritur që t'i adresoj rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe se “informacioni i shpalosur nga komuna për vitin 2011 mbi pasuritë fikse është jo i plotë dhe i pasaktë dhe se pagesat e bëra nga palët e treta dhe informatat shtesë për të pagueshmet dhe të arkëtueshmet është jo i plotë.”¹⁴

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Kushtetuta e republikës së Kosovës njeh se dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet shtetërore janë *publike*, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.¹⁵ Për më tepër në bazë të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (neni 68.5) Çdo person mund të kontrollojë çfarëdo dokumenti që mbahet nga komuna, përveç nëse zbulimi i tillë nuk është i ndaluar sipas ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

E drejta për qasje në dokumentet publike është njohur ligjërisht dhe realizuar praktikisht në pothuajse çdo vend demokratik. Është legjitime që publiku dëshiron të dijë çdo gjë lidhur me komunën, institucionet dhe ndërmarrjet nën autoritetin e saj dhe zyrtarët komunal. Ligji për qasje në dokumente publike është mekanizëm që u mundëson qytetarëve që t'i shqyrtojnë dokumentet komunale dhe të dhënat që mbahen nga komuna. Në përgjithësi, publiku ka të drejtë të informohet lidhur me këto çështje: Organizimi i brendshëm i komunës, Rregulloret, vendimet dhe aktet e tjera komunale, komitetet këshillëdhënëse, planet e komunës, informatat financiare etj.

Në bazë të raporteve të rregullta të zyrës për qasje në dokumentet publike, komuna e Ferizajt për këtë gjashtëmuor ka pranuar gjithsej 13 kërkesa për qasje në dokumente publike. Numri më i madh i kërkesave ka qenë nga shoqëria civile. Prej 13 kërkesave të pranuar, 9 prej tyre kanë marr përgjigje pozitive, 1 kërkesë është akoma në proces e sipër, kurse 3 janë refuzuar. Janë shqetësuese arsyet e refuzimit të këtyre kërkesave ku në rastin e parë INPO duke u mbështetur në Ligjin për Qasje në Dokumente i ka kërkuar drejtorisë së Urbanizmit, Pronës, Kadastrit, Gjeodezisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit qasje në Raportin për gjendjen mjedisore të komunës të vitit 2010 dhe 2011.

Sipas ligjit për Mbrojtje të Mjedisit dhe rregullores së Komunës së Ferizajt për Mbrojtjen e Mjedisit, Drejtoria e UPGJMM në bashkëpunim më drejtoritë e tjera, është e obliguar që ti paraqes Kuvendit raportin një vjeçar për gjendjen mjedisore të Komunës, i cili përveç të tjerash duhet të përmbajë të dhëna për gjendjen ekzistuese të mjedisit dhe ndryshimet në mjedis, ndikimet mjedisore në shëndetin e banorëve të Komunës, dëmet, qëndrueshmërinë e përdorimit

¹⁴Zyra e auditorit të përgjithshëm(2012): Raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të komunës së Ferizajt , fq. 9.

¹⁵ Kushtetuta e republikës së Kosovës, neni 41

të burimeve natyrore, implementimin e planeve lokale për veprim në mjedis dhe planeve tjera, si dhe efektin e tyre në zhvillimin ekonomik etj.

Drejtoria i ka refuzuar INPO-s qasjen në këtë dokument me arsyetimin se Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është i publikuar në web faqen zyrtare të Komunës si dhe raportet e drejtorisë përveç anëtarëve të kuvendit ju dorëzohen edhe medieve e shoqërisë civile. Arsyetimi ishte i pabazë dhe nuk kishte të bëjë me dokumentin të cilin INPO e ka kërkuar.

Dokumenti të cilin INPO kishte kërkuar nuk i është paraqitur asnjëherë Kuvendit dhe as që është hartuar ndonjëherë. Kjo dëshmon se marrëdhëniet mes ekzekutivit dhe legjislativit të komunës janë të nivelit të ulët, ekzekutivi i Komunës as që mundohet të përmbush obligimet e veta ligjore që i ka ndaj Kuvendit dhe qytetarëve mirëpo as kuvendi nuk po mund të ushtroj kontroll dhe të kërkojë llogari nga ekzekutivi.

Rasti tjetër i refuzimit të kërkesës për qasje në dokumente zyrtare është ai kur Drejtoria për Arsim ka refuzuar pa asnjë arsye dy kërkesa të një studenti për qasje në dokumente publike. Pikërisht drejtoria e cila do të duhet t'i inkurajonte të rinjtë për pjesëmarrje aktive në rrjedhat shoqërore – arsimore – komunale ajo ka refuzuar dy kërkesa të një të riut ferizajas që të përmbush të drejtën e tij të garantuar me ligj për qasje në dokumente publike. Drejtoria për Arsim do të duhet të merrte së paku mundin për të dhënë një arsye për refuzim të kërkesave apo t'ia sqaronte studentit kontestin e refuzimit. Këtë informacion ia e kanë dhënë burimet zyrtare të komunës monitoruesve të INPO – s por nuk e kanë bërë publik emrin e studentit dhe as natyrën e kërkesave të tij.

PJESËMARRJA PUBLIKE

Shprehja *pjesëmarrje publike* është komplekse dhe ka shumë kuptime, megjithatë në këtë raport termi pjesëmarrje publike i referohet procesit të angazhimit të publikut në punët e komunës gjatë ushtrimit të kompetencave të saj. Ideja e pjesëmarrjes publike është që kur komuna synon të nxjerr ndonjë vendim që ka ndikim tek publiku, publiku duhet të informohet rreth atij vendimi, në Kosovë pjesëmarrja publike ka bazë ligjore dhe mbështetet në parimin e subsidiaritetit.¹⁶

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale parasheh shumë mekanizma se si qytetarët mund të marrin pjesë në çështjet lokale dhe ofron një kapitull të veçantë të quajtur Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve (Kapitulli IX). Në këtë kapitull paraqiten gjashtë mekanizma që e fuqizojnë pjesëmarrjen publike në nivelin lokal. Këta mekanizma janë: Informimi publik dhe konsultimi, e drejta e peticionit, iniciativa e qytetarëve, referendumit, largimi i kryetarit, dhe komitetet konsultative.

¹⁶ Parimi i subsidiaritetit thotë se çështjet publike realizohen, sa më shumë që të jetë e mundur në interes të qytetarëve nga niveli më i ulët i qeverisë që është në gjendje të ofrojë shërbime efikase.

Referendumi dhe largimi i kryetarit i ofrojnë publikut fuqinë e plotë të vendimmarrjes, kurse mekanizmat tjerë janë ose shprehje paraprake e mendimit sa i përket çështjeve komunale ose janë ankesa kundër akteve dhe aktiviteteve komunale, që nuk janë të detyrueshme për komunën por sidoqoftë nuk mund të merren vetëm si mekanizma formal.

Komuna e Ferizajt vë në jetë pjesëmarrjen publike përmes disa metodave. Komuna siç është e obliguar edhe me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale ka mbajtur periodikisht takime publike me qytetarë, në komunën e Ferizajt ekziston kutia e sugjerimeve dhe ankesave të qytetarëve, komuna ka përgatitur dokumentin që njihet si “buxheti shkurt” ku ka ofruar një përmbledhje të buxhetit si dhe ka botuar udhëzuesin e qytetarit që ofron informacione gjithëpërfshirëse rreth komunës.

DËGJIMET PUBLIKE

Komuna e Ferizajt gjatë këtij gjashtëmujori ka mbajtur gjithsej tri dëgjime publike, në qershor 2012 organizoi dëgjimin publik me temë zhvillimi i projekteve kapitale për vitin fiskal 2012, në korrik 2012 organizoi dëgjimin publik mbi draftimin e planit të veprimit për rini si dhe dëgjimi publik mbi kornizën afatmesme buxhetore 2013-2015 që dështoi pasi që në të mori pjesë vetëm një qytetarë.

Edhe pse janë mbajtur dy dëgjime publike dhe një ka dështuar, INPO vlerëson se Komuna po organizon dëgjime publike krejt në fund të procesit pasi që vendimet të jenë marrë. Komuna e Ferizajt në rend të parë duhet të ketë parasysh që të mbaj dëgjimet para se të filloj procesi, sidomos para miratimit të vendimeve të rëndësishme. Gjithashtu për INPO-n është mjaftë shqetësues fakti që qytetarët e ‘bojkotojnë’ dëgjimin publik mbi kornizën afatmesme buxhetore, kur dihet rëndësia dhe impakti që ka korniza buxhetore tek qytetarët. Bojkoti i publikut duhet të përbëj preokupim serioz për komunën e Ferizajt, ngase jo vetëm që po e ulë përgjegjësin e komunës si bërës i politikave por i vë në pikëpyetje të gjitha parimet e qeverisjes së mirë në të cilat komuna mbështetet.

5. EFIKASITETI I DREJTORIVE

Administrata komunale e Komunës së Ferizajt përbëhet nga gjithsej dhjetë drejtorate dhe dy zyre të cilat janë bartëse të projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

Puna dhe shkalla e efektivitetit të drejtorive komunale ka qenë në fokus të monitorimit të INPO-s në këtë gjashtë muor. Në drejtorinë bujqësisë INPO-ja ka vlerësuar se projekti kryesor për 6 mujorin e parë të këtij viti ka qenë dhënia e subvencioneve në vlerë prej më se 100.000 euro. Këto subvencione janë dedikuar për luftimin e barojave të këqija dhe janë planifikuar për fermerë me hapësira 5.5 hektar, fermerë këta të cilët janë të evidentuar nga Ministria. Sipas

drejtorit Safit Halitit, sipërfaqet e përfshira me këtë herbicid janë 1375 hektar me nga 150ml për hektar me vlerën e kushtuar 20,185, përfitues kanë qenë 88 fermerë.

Një formë tjetër e subvencionimit ka qenë edhe në ngritjen e serrave familjare. Ku është planifikuar të shpërndahen 90 copë në hapësirë 45m² dhe me këto janë pajisur 90 familje/fermerë. INPO përkrah rritjen e mjeteve për subvencionin në bujqësi por kërkon që të ketë më shumë transparencë në mënyrën e ndarjes së tyre. INPO-ja konsideron se kuvendi komunal është vonuar me nxjerrjen e një rregulloreje për ndarjen e subvencioneve dhe një gjë e tillë, pritet të ndodhë në pjesën dytë të gjashtë mujorit të këtij viti. Po ashtu INPO-ja e sheh si mungesë të transparencës së plotë edhe faktin se kuvendi komunal nuk është njoftuar me shumë aspekte të ndarjes së subvencioneve.

INPO ka çmuar punën e kësaj drejtorie në ndarjen e ndihmave në dru zjarri që i është ofruar disa qytetarëve në raste emergjente (gjatë muajve të dimrit) dhe ndihmën me nga 2 metra dru 17 familjeve të cilat kanë qenë me ndihmë sociale dhe në varfëri të tejskajshme. Gjithsej u ndihmuan 37 familje. Kjo sasi e drunjve është marrë nga drunjte e konfiskuara në depo.

Edhe pse si një nevojë praktike pothuaj e domosdoshme aksioni i eliminimit të qenve endacak lë shumë çështje për t'u diskutuar. Ai sivjet komunës i ka kushtuar 2620 euro, vetëm për municionin, mëditje, për automjetet që i ka shfrytëzuar shoqata e gjuetisë për 6 ditë si dhe shuma tjetër prej 2600 euro që i ka shpenzuar ndërmarrja "Pastërtia" në groposje, bartje, dizinfektim dhe varrosje. Mirëpo, është koha që organet komunale të hulumtojnë metoda më "humane" të strehimit të qenve endacak dhe të kontrollimit të shtimit të tyre.

Ndërkaq vaksionimi i qenve me pronar, përkundër që është një hap i mirë shikuar nga aspekti i shëndetit publik, ndarja e një shume kaq të madhe prej më se 6900 euro, për INPO - n është i pajustificueshëm. Aksioni ka përfshirë të gjithë qytetarët që kanë poseduar një a më shumë qenë familjar. Kur është fjala për vendime të tilla INPO kërkon që për këtë të diskutohet në kuvend nga ana e këshilltarëve sepse me kërkesa të njëjta për subvencione mund të paraqiten shumë komunitete edhe me nevoja më urgjente, dhe në fund të fundit mbajtja e qenve shtëpiak është vullnet i lirë i qytetarëve dhe para se ata të subvencionohen ata duhet të obligohen për kujdesin ndaj kafshëve të tyre. INPO kërkon që të bëhet publike lista e vaksionimit të qenve si dhe lisat e plotë e qytetarëve që kanë qenë shtëpiak.

INPO në disa raste ka ngritur shqetësimet për gjendjen e rëndë të pyjeve për shkak të dëmtimeve serike të tyre. Edhe në drejtorinë e bujqësisë kanë folur për vështirësi në sektorin e pylltarisë, posaçërisht në punën e rojeve, për shkak se nuk kanë mjete të mjaftueshme për punë, as kushte. Mungojnë armët mbrojtëse, nuk kanë mjete të informimit dhe i nënshtrohen rrezikut vazhdimisht. Problem tjetër në raport me funksionimin e shërbimit të rojeve të pyjeve sipas monitoruesve të INPO-s është se ata shpesh nuk rrinë në vendet e tyre të punës dhe dyshime të bazuara se ata shpesh edhe koketojnë për përfitime të ulëta me stërshitësit ilegal të druve. INPO ka shënuar se kjo drejtori nuk është mbuluar me staf të nevojshëm, nisur nga fakti se punët e saj

janë shumë të shpërndara në terren. Edhe tek sektori i pylltarisë stafi nuk mjafton sepse nga p.sh gjithsej 11 mijë hektarë që duhet mbuluar, i bie që një rojë mbulon 1500 hektarë.

Në drejtorinë e administratës së përgjithshme OJQ INPO ka vlerësuar si sukses funksionalizimin e qendrës për shërbim të qytetarëve, projekt ky konform MAPL -së. Edhe unifikimi i protokollit unik të komunës ka qenë një hap i duhur si dhe disa veprime të tjera rreth projektit të kërkesave të gjendjes civile. Sipas drejtorit Vesel Zhinipotoku me qëllim të kursimit të shpenzimeve telefonike është krijuar rrethi i brendshëm, ku në kuadër të kësaj funksionojnë pa pagesë telefonat e të gjithë zyrtarëve të institucioneve si shkolla biblioteka, emergjenca etj. Mirëpo OJQ INPO shpreh habinë se pse shpenzimet për telefona kanë arritur sërish shkallë të lartë të harxhimeve sipas raporteve zyrtare për shpenzimin buxhetit, andaj këto ndërhyrje të kësaj drejtorie do t'i përcjellim me kujdes që t'i shohim efektet eventuale pozitive në kursimin e parasë publike.

Kjo drejtori por as komuna nuk ka bërë mjaft për të ndihmuar rreth mosmarrëveshje që kanë lindur në mes të banorëve të zyrës së gjendjes civile të fshatit Gaçkë dhe Greme, rreth ndërtimit të Zyrës së vendit. INPO në reagimet e saja të rregullta ka ngritur zërin për heqjen e dy projekteve për ndërtimet zyrtare të vendit, me rastin e rishikimit të buxhetit për vitin e mbetur.

As sivjet nuk është vërejtur ndonjë shërbim plotësues për kohën e pushimeve verore kur dihet se në këtë kohë vërshojnë mërgimtarët tanë dhe ata kanë nevojë për një linjë të veçantë të shërbimeve, për tu pajisur me dokumentacionin e nevojshëm.

INPO kërkon që kjo drejtori të bëjë më shpejt funksionalizimin e plotë të arkivës së administratës komunale, pastaj sistematizimin e vendeve të punës sipas rregullativës ligjore që është në fuqi pas miratimit të ligjit për Ligjin civil.

Po ashtu realizimi i projektit të ueb - sms për marrjen e përgjigjeve në mënyrë elektronike do të shtonte efikasitetin e kësaj drejtorie. Drejtori Zhinipotoku ka premtuar se hartimi i draft rregullore për funksionalizimin e shumë shërbimeve për nevojat e administratës së komunës, janë cak i tij, andaj INPO do të kërkon që me kohë të bëhet hartimi i këtyre rregulloreve.

Edhe në drejtorinë për ekonomi dhe financa INPO ka gjetur dy anë të medaljes. Në njërin anë një vëllim të madh të punës por në të tjetrën një mungesë të theksuar të stafit. Drejtori Mustafë Grainca nuk është përgjigjur në dy pyetje të INPO-s, për projektet kryesore që ka pasë drejtorja e tij si dhe për vështirësitë që kanë karakterizuar punën e tij, por ai ka folur për organizimin e drejtorisë së tij nëpër sektorë. Puna është e organizuar sipas planit vjetor. Drejtorja ka 2 sektorë: të të hyrave dhe të shpenzimeve.

Këto dyja gjithashtu kanë njësi, është udhëheqësi i njësive, udhëheqësi i sektorëve edhe stafi teknik që përkujdesen për implementimin e planeve në fillim të vitit. Përkundër që planet projektohen në bashkëpunim me drejtorin dhe udhëheqësve të njësive, INPO konsideron se këto

plane duhet të bëhen më të afërta për qytetarët, parme publikimeve dhe sqarime më të shpeshta. Sipas Graincës ka edhe plane mujore ku hartohen politika për të hyra vetanake, pasataj plani i shpenzimeve etj., por të gjitha këto plane sado që mund të sjellin efekte në punë nuk janë të njohura për publikun.

Posaçërisht sektori i të hyrave nuk ka staf të mjaftueshëm, po në drejtori pohojnë se pavarësisht kësaj për sa i përket drejtorisë, ajo ka shënuar efikasitet në anën profesionale. në dy sektorë ka staf profesional disa veç me përvojë pune ka edhe te tjetër me nivel profesional. Kërkesë është që stafi i sektorit të të hyrave të rritet.

Edhe pse ka pasur suksese në realizimin e të hyrave vetanake, zgjedhjet e jashtëzakonshme kanë krijuar një atmosferë demobilizuese tek qytetarët të cilët në këtë fazë kanë hezituuar t'u përgjigjen obligimeve të pagesave - si tatimi në pronë.

Drejtorja për Emergjencë dhe Shërbime Publike për këtë vit kishte dy projekte kryesore: ndërtimin e qendrës së zjarrfikësve dhe furnizimin me dy autocisterna.

Edhe drejtori Ibrahim Hyseni nuk ka cekur ndonjë vështirësi të veçantë në kryerjen e punëve, derisa INPO konsideron se kësaj drejtorie i ka munguar një strategji nëpërmjet të cilës do të parashikoheshin masat për raste emergjente.

Drejtorja për Emergjencë dhe Shërbime Publike është vënë në sprovë veçanërisht gjatë muajve të parë të vitit 2012 kur reshjet e mëdha të borës vështirësuan lëvizjen në qytet dhe bllokuan disa fshatra të komunës. Kësaj drejtorie pikërisht për shkak të mungesës së një strategjie për rastet emergjente i është dashur që në ditët kritike të kontraktojë kompani private për pastrimin e rrugëve dhe të paguajë derivatet për punën e këtyre kompanive pasi që kompania rajonale e mbeturinave "Pastërtia" e cila ka kontratë me komunën e Ferizajt kishte dështuar t'i përmbushte obligimet e veta.

Mungesa e stafit është ndjeshme edhe në këtë drejtori, ku posaçërisht vërehet mungesa e një inxhinieri të ndërtimtarisë. Është indikativ fakti që tek Brigada e zjarrfikësve për shkak të mungesës së stafit angazhohen vullnetarë të cilët paraprakisht bëjnë një marrëveshje me kryetarin e komunës. INPO shpreh shqetësimin për këto raste sepse paraprakisht ata persona duhet të trajnohen për raste specifike me të cilat mund të përballen pavarësisht prej vullnetit të tyre të mirë. Moshë e shtyrë e stafit të trashëguar nuk iu përgjigjen kërkesave momentale të punës .

Në këtë drejtori janë ankuar se niveli i subvencioneve që sillen nga 30-35 mijë euro është i vogël, dhe kjo gjë nuk lejon të jenë afër qytetarëve në raste të ndonjë fatkeqësie si p.sh shkatërrim të shtëpive nga zjarri, nuk bëhet kompensimi plotësisht, por sado pak ndihmohen me blerjen e dyerve e dritareve.

Në Drejtorinë për Planifikim dhe Zhvillim është shënuar një vëllim i madh i projekteve që kanë të bëjnë me investime kapitale prej më se 60 sish. Pjesa e parë e projekteve fillojnë në verë, shumica si kanalizime, shkolla, zjarrfikës, emergjenca dhe të gjitha këto janë paraparë për 6 mujorin tjetër të kryhen, kurse deri në nëntor parashihet përfundimi i të gjitha këtyre projekteve, ka bërë të ditur drejtori Ardian Ferzi.

Si vështirësi në punën e realizimit të projekte del të paraqesin pronat e uzurpuara që ende nuk janë liruar, pastaj kushte atmosferike ndikojnë në shtyrjen e fillimit të punimeve. INPO sugjeron që drejtoritë të mos presin fillimin e realizimit të projekteve për t'i liruar pronat e uzurpuara, por kjo duhet të jetë një strategji afatgjatë e komunës. Edhe rastet e vështirësive në terren dhe mosmarrëveshjet shpeshhta me qytetarët, INPO i sheh si paaftësi të komunës për të vënë një komunikim më të drejtpërdrejt me qytetarët dhe për t'ua sqaruar atyre me kohë rëndësinë e realizimit të projekteve. Thirrja në ndihmë e PK-së tregon paaftësinë e komunës për të komunikuar me qytetarët.

Sfidë e kësaj drejtorie mbetet mbikëqyrja e realizimit të projekteve, pasi që jo njëherë është vërejtur mos kryerja si duhet e projekteve dhe mungesa e kualitetit të punimeve. Përkundër që komuna ka angazhuar së fundi një kompani private për të mbikëqyrë punimet INPO bën ftesë publike kryetarit dhe organeve të tjera që të rrisin përgjegjësinë tek firmat kontraktuese qoftë edhe me kërcënim për ndëshkimin e tyre nëse nuk i kryejnë me kohë dhe si duhet punimet. INPO ka ngritur shqetësimin e saj në disa raste kur janë bërë shkelje të rënda të realizimit të projekteve siç është rasti tek rrugët “Epopeja e Jezercit” si dhe tek ajo “Enver Topalli”. INPO konsideron si oportunitizëm të pushtetit karshi firmave punë kryerëse kur pohohet se komuna nuk po humbë asgjë sepse firmat i kompensojnë riparimet. Kjo gjë nuk qëndron dhe është një qasje jo kreative sepse me këtë rast qytetarët janë ata që i “pagojnë” vonesat e mbarimit të punimeve me shërbimin e dobët që u ofrohet atyre dhe me pengesat e shumta gjatë qarkullimit.

6. EFIKASITETI I BASHKËSIVE LOKALE

Gjatë muajit qershor, INPO ka monitoruar zhvillimet nëpër disa fshatra të komunës së Ferizajt për të parë nga afër pasojat e marginalizimit të fshatit nga pushteti lokal dhe për të mësuar më shumë për vështirësitë me të cilat përballen çdo ditë banorët e tyre.

Gjatë procesit të monitorimit INPO posaçërisht është përqendruar në aktivitetin e zyrave të gjendjes civile (zyrat e vendit) nëpër fshatra, ku ka vërejtur se disa nga këto zyra të gjendjes civile nuk po funksionojnë siç duhet dhe po e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kushte jo adekuate për punë.

Në fshatin Kosinë, banorët e këtij fshati vazhdojnë të kenë probleme me furnizimin me ujë të pijshëm si dhe sipas banorëve aty është e nevojshme një fushë e sportit dhe rregullimi i rrethojë së shkollës. Në një lagje të fshatit Zaskok kanalizimi nuk ka përfunduar së rregulluari, po ashtu

banorët janë ankuar se kanë probleme me ujin sepse gypat e ujësjellësit janë të vjetruar dhe ata shpërthejnë shpesh. Ujit të pijes i vjen era dhe nuk është i përdorshëm për pije. Në këtë fshat gjithashtu nuk ka as Punkt të mjekësisë familjare.

Në fshatin Nerodime banorët kanë shfaqur një pakënaqësi të madhe për shkak të gjendjes së rëndë të rrugës, kurse hedhja e mbeturinave përgjatë rrjedhës së lumit Nerodime është alarmante. Gjithashtu banorët vazhdojnë të përballen edhe me mungesa të ujit të pijes. Ndërsa sa i përket zyrës së vendit në Nerodime, kur monitoruesit e INPO-s e vizituan zyra ishte e mbyllur dhe nga banorët e kuptuam se zyrtari i gjendjes civile kishte dalur për punë personale.

Në fshatin Gaçkë gjithashtu kemi hasur një gjendje tepër të rëndë në Zyrën e Vendit, ajo ishte kapluar nga myku dhe lagështia derisa kulmi i saj pothuajse ishte rrënuar. Kur dihet se në këtë Zyrë pajisjen me dokumente të gjendjes civile banorët e Gremes, Gaçkës, dhe Burrnikut (fshatra këto me popullsi mjaft të madhe) dhe se ata çdo ditë duhet të përballen me këto kushte të padenja për kohën që po e jetojmë.

Një gjendje të njëjtë tepër degraduese kemi parë edhe në Zyrën e vendit në fshatin Kosinë, ku shërbimet e gjendjes civile i kërkojnë zonat: Lloshkobare, Slivovë, Kosinë, një pjesë e Terrnit dhe Prelezi i Jerlive. Aty mungojnë kushtet elementare të nevojshme për punë, duke filluar që nga inventari i nevojshëm për radhitjen e dokumentacionit, pastaj mungesa e tavolinave dhe karrigeve pritëse për palët, e deri te kulmi i cili rrezikon të shembet. Gjendja e njëjtë me kushte jo të favorshme për punë është edhe në fshatin Talinoc.

Përveç kushteve të punës, INPO ka vërejtur se zyrtarët e shërbimit civil që punojnë në zyrat e vendit nëpër fshatra shumë shpesh nuk qëndrojnë në vendin e tyre të punës dhe kështu po shtohen pritjet e qytetarëve në radhë siç ishte rasti në Nerodime apo edhe në Softaj.

Ankesa prej qytetarëve për mos respektimin e orarit kemi shënuar në shumicën e fshatrave e posaçërisht në fshatin Babush. Një gjendje më e mirë e zyrave të vendit është në Fshatin e Vjetër dhe në Dardani. Ku objektet e tyre janë në gjendje të mirë dhe funksionale, dhe se gjatë monitorimit nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.

INPO kërkon nga Komuna e Ferizajt që të zbatoj obligimet ligjore që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (konkretisht neni 34.2 i LVL që thotë se Me aprovimin e komunës, fshatrat apo lagjet urbane mund të kryejnë aktivitete që bëjnë pjesë në përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës dhe në këtë rast komunat duhet të ofrojnë burimet e mjaftueshme për fshatrat apo lagjet urbane), si dhe Komuna duhet të qëndrojë sa më afër këtyre Zyrave të Vendit kur dihet rëndësia e shërbimeve që ato kryejnë.

Me rastin e rishikimit të buxhetit për vitin fiskal 2012 u hoqën e projektet e parapara për ndërtimin e Zyrave të Vendit në fshatin Gaçkë dhe Kosinë gjatë vitit 2012, duke zvogëluar vlerën e tyre për 25 mijë euro dhe duke e rritur vlerën e projekteve ekzistuese siç është blerja e

automjeteve për administratën komunale në vlerë prej 10 mijë euro. Me heqjen e prioritetit të këtyre projekteve nënkuptohet se do të vazhdojë gjendja e rëndë nëpër këto Zyra dhe vështirë se do të ketë investime në Zyrat e tjera. Kjo rishpërndarje e buxhet nuk korrespondon me nevojat reale të qytetarëve dhe më shumë anon kah shpenzimet e luksit.

INPO kërkon nga komuna e Ferizajt dhe Drejtoria e Financave që në planifikimin e buxhetor për vitin 2013 t'i rikthejë projektet për rindërtimin e Zyrave të Vendit në Gaçkë dhe Kosinë dhe të shtrijë pushtetin në mënyrë sa më proporcionale dhe të efektshme edhe në zonat rurale të Komunës së Ferizajt.

7. ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË FERIZAJT

RAUNDI I PARË I ZGJEDHJEVE


Në muajin Mars Gjykata Supreme konfirmoi dënimin e Kryetarit të Komunës së Ferizajt z. Bajrush Xhemali. Ish Kryetarit të komunës gjykata supreme i përfundoi mandatin para kohe duke e shkarkuar. Rrjedhimisht pas shkarkimit të Kryetarit, Komuna e Ferizajt shkoi në zgjedhje të jashtëzakonshme, të cilat u mbajtën me datë 29 Prill 2012.

Procesi zgjedhor është monitoruar si në raundin e parë ashtu edhe në dytin në gjithë zinxhirin e tij, duke filluar që nga fushata paraelektorale e deri tek dita e votimit dhe numërimi i votave.

Fushata paraelektorale ka sjell në qytet atmosferat tash të njohura të një konkurrence politike e përcjellur shpesh me një gjuhë të akuzave. Në garë ishin shtatë kandidatë për kryetarë qyteti, nga partitë politike: PDK, LDK, AAK, VV, AKR, LB, PD dhe kandidati i pavarur Rrahim Sadiku. Premtimet e kandidatëve si dhe sjellja e tyre konform rregullave zgjedhore ishin cak i monitorimit, duke i shënuar shkeljet që ndodhnin posaçërisht të natyrës së zënies së posterëve apo të fillimit të fushatës jashtë kohës së paraparë. Mirëpo duhet thënë se përkundër një fryme konkurruese, deri në etiketime të natyrës së akuzave për korrupsion apo të cilësimeve të natyrës së kontestimeve morale dhe politike, INPO nuk ka shënuar shkelje të rënda të rregullave të fushatës.

INPO me këtë rast ka qenë partnere kryesore e OJQ-së D4D dhe kemi pasur vëzhgues në çdo vendvotim. Monitoruesit dhe vëzhguesit tanë me përkushtim kanë përcjellë çdo parregullsi rasti për të cilat kemi raportuar nga ora në orë duke i dhënë tërë procesit një besueshmëri të veçantë. Posaçërisht ka qenë indikative puna e INPO-s me rastin e shpalljes së rezultateve, para çdo subjekti tjetër dhe të cilat reflektonin me saktësi rrjedhën reale të votave.

Rezultatet e raundit të parë të zgjedhjeve u ndanë në këtë mënyrë në mes të kandidatëve duke qar në balotazh kandidatët e PDK – së dhe LDK –së.



Edhe pas përmbylljes së tërë procesit zgjedhor INPO ka përcjellë zhvillimet në komunë dhe ka tërheqë vërejtjen për zvarritjen procesit të formimit të qeverisë së re komunale. Është për keqardhje në frymë të kundërt me zhvillimet demokratike vonesat e formimit të qeverisë lokale. As me rastin e shkruarjes së këtij raporti për më shumë se dy muaj nga përfundimi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme, as kryetari i ri dhe as PDK – ja, partia që ka shumicën e këshilltarëve nuk kanë arrit as ta formojnë Qeverinë e re. Për INPO- n është e papranueshme dhe thellësisht jodemokratike që partia në pushtet gjatë kësaj kohe ka shpallur dhe njëkohësisht ka anuluar disa herë koalicionet e mundshme herë me AAK-në e herë me AKR-në e ndonjëherë së bashku me të dyja. Për INPO, gjithashtu është e pakuptueshme edhe heshtja partive opozitare të cilat sikur janë vetëmjaftuar me humbjen në zgjedhje dhe asnjëherë nuk e kanë ngritur zërin për vonesat e formimit të qeverisë lokale.

Gjatë kësaj periudhe INPO-ja ka bërë edhe monitorimin e punës së kuvendit komunal duke përcjell marrjen e vendimeve pastaj punën e KPF-së si dhe raportin në mes të legjislacionit si dhe të ekzekutivit. Mirëpo INPO-ja ka shpreh edhe shqetësimin e saj për mosfunksionimin e kuvendit komunal, gjatë procesit të zgjedhjeve për postin e kryetarit, pasi që kryesuesi i kuvendit nuk kishte dhënë dorëheqje nga ky post as pas kandidimit të tij për garën zgjedhore për kryetar. Shih për këtë për më shumë se dy muaj kuvendi nuk ka mbajtur asnjë seancë. INPO konstaton se zgjedhjet e jashtëzakonshme sado të imponuara nuk janë menaxhuar mirë, për t'i zvogëluar të

gjitha pasojat që i përmendëm më lartë, andaj gjatë kësaj kohe lirisht mundtë thuhet se kemi pasur shkëputje institucionale të funksionimit të organeve komunale.


RAUNDI I DYTË I ZGJEDHJEVE

Edhe raundi i dytë i zgjedhjeve u zhvillua në një frymë të pranueshme për një garë për postin e kryetarit të Ferizajt. Edhe pse fushata zgjedhore e raundit të dytë zyrtarisht zgjati më pak, edhe kandidatët e mbajtur në garë Agim Aliu i PDK - së dhe Adem Salihaj i LDK- së, nuk treguan shumë vullnet për të qenë “agresivë” në publik. Fushatat e tyre u drejtua për takime me grupe të caktuara të interesit, shpesh larg syve të opinionit. INPO ka vëzhguar tërë fushatë paraelektorale si dhe ditën e zgjedhjeve. Disa nga parregullsitë të cilat karakterizuan këtë raund të zgjedhjeve dhe u identifikuan nga vëzhguesit e INPO – s ishin:

1. Menaxherët e shkollave në disa raste nuk kanë qenë të pranishëm për të marrë listat e votuesve, gjatë procesit të dorëzimit të materialit të ndjeshëm;
2. Kryesuesit e vendvotimeve në disa raste nuk kanë qenë të pranishëm gjatë marrjes së materialit të ndjeshëm;
3. Gjatë ditës së shtunë, kur edhe bëhet rregullimi i vendvotimeve, një numër i komisionarëve nuk kanë marrë pjesë në këtë proces;
4. Ka pasur një koordinim të mirë në mes të policisë së Kosovës dhe KKZ-së.
5. Në qendrën e votimit, 2501X (shkolla Pjetër Bogdani), vendvotimi 07, ka ndodhur një fjalosje në mes të komisionarit të LDK-së dhe atij të AKR-së. Në qendrën e votimit 2513D, vendvotimi 04 (fshati Talinoc), një personi i është lejuar që të votojë me kopje të letërnjoftimit, pasi që ky votues paraprakisht kishte kërcënuar komisionerët. Në të njëjtën qendër, së paku dy votues që nuk e kanë gjetur emrin në listën e tyre të votuesve, personat zyrtarë në tavolinën ndihmëse u kanë thënë që të kthehen në shtëpi, pa u ofruar opsionin e votimit me kusht.
6. Në qendrën e votimit 2504D, vendvotimi 06 (shkolla Zenel Hajdini), kryesuesi i vendvotimit ka asistuar në votim një person të shtyrë në moshë duke i dhënë instruksione se për kë të votojë. Ajo çka është vërejtur në përgjithësi nga vëzhguesit tanë është një jo-seriozitet i komisionarëve të cilët në vazhdimësi janë duke i lëshuar vendvotimet për periudha të gjata kohore, duke i lënë vendvotimet me vetëm dy-tre komisionerë.

Si në raundin e parë ashtu edhe në raundin e dytë INPO-ja ka bërë një fushatë sensibilizuese por të dalë të rinjtë në votim nëpërmjet performancave të saj dhe shpërndarjes së fletushkave.

Edhe në raundin e dytë kandidati i PDK-së ka arritur të ruaj përparësinë e votave, në krahasim me kandidatin e LDK-së. INPO a ka vërejtur shumë dobësi në sistemin e votimit dhe për të gjitha ka raportuar me kohë sipas fazave të ditës së votimit por në tersi këto lëshime nuk kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar.



Shih për këtë është pranuar edhe rezultati përfundimtar i zgjedhjeve edhe nga kundër - kandidati Salihaj. Përmbyllja procesit të zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Ferizaj, ka krijuar hapësirën për të kompensuar kohën e humbur për në qeverisjen lokale dhe për dinamizmin e punëve. Mirëpo siç cekëm edhe më lart kjo gjë nuk ka ndodhur me fuqinë e plotë pasi që kryetari i posa zgjedhur nuk pati mundësi të formojë qeverinë e re lokale, pasi që këtë nuk e lejuan kombinimet e shumta politike rreth koalicioneve. INPO ka mësuar se tash më kjo gjë është lënë për pas pushimeve verore dhe kjo tregon një papërgjegjësi si të kryetari ashtu edhe të partisë në pushtet PDK-së.

8. KUVENDI KOMUNAL - VENDIMET

INPO e ka parë me sy të mirë vendimin për caktimin e mbledhjeve të KK për vitin 2012, mirëpo ky vendim në gjashtë mujorin e parë nuk është respektuar pothuaj fare, për shkak të mos mbajtjes së mbledhjeve të KK-së gjatë periudhës së zgjedhjeve.

Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për të hyra vetanake të komunës 01NR. 6580 e datës 29.12.2008 është paraqitur nga pozita si dobiprurëse edhe pse ka pasur segmente kontestuese nga opozita. INPO mendon se në këto raste duhet shqyrtime me bazë më të gjerë,

sepse këto vendime shprehin esencën e një qeverisje të mirë apo të dështuar. Po ashtu konsiderojmë se kjo rregullore nuk është mirë të ndërrohet në çdo gjashtë muaj sepse kështu lë përshtypjen se këto ndryshime bëhen për qëllime konjunkturale dhe për politika të interesave të ngushta.

Edhe pse vendimi për dhënien në diskutim publik të projekt rregullores për ndarjes e subvencioneve është marrë shumë herët në kuadër të 6 mujorit të parë kjo gjë nuk ka ndodhur, andaj komuna nuk duhet të merr vendime para se të jetë e gatshme të fillon zbatimin e tyre.

Vendimin për rritjen dhe bartjen e të hyrave nga viti fiskal 2011 INPO e sheh si paaftësi të komunës për të menaxhuar si duhet me paranë publike, bartja e të hyrave prej vitit në vit vazhdon të sfidojë qeverisjen e mirë komunale. Rritja e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2011 bëhet në vlerë prej 47.038,03 euro, kurse bartja e të hyrave vetanake nga viti 2011 në vitin 2012 bëhet në vlerë prej 1.174.508,86 euro.

Shqetësimi i INPO-s për ndërhyrje të shpeshta të qeverisë me vendimet për ndryshimin e rritjes dhe të bartjes së të hyrave vetanake nga viti fiskal 2011 ka dalur të jetë i saktë sepse edhe gjatë muajit mars sërish kemi pasur një ndërhyrje të tillë.

Në paragrafin I, pika 1, shuma prej 47.038,03 euro është zëvendësuar me shumën 502.207,97 euro; kurse në pikën 2, shuma prej 1.174.508,86 euro, është zëvendësuar me shumën 1.123.693,65 euro.

Vendimet e KK-së për plotësimin e vendimit për hartimin e planit zhvillimor urban me elemente të planit rregullues për qendrën sekondare urbane Softaj i kanë hapur derë realizimit të këtij projekti të rëndësishëm për këtë zonë rurale, sikurse edhe vendimet për hartimin e planeve rregullative urbane për zonat nr. 3,6 dhe 7 që kanë bërë të mundshme fillimin e këtyre planeve tepër me peshë për këto zona.

Në anën tjetër INPO nuk i mirëpret vendimet për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore për një sërë ngastrash kadastrale si psh.nr. 320, 321, 322, 323 etj., pasi që konsiderojmë se duhet shmangur vendimeve të tilla për të mbrojtur tokën e bukës e cila çdo ditë e më shumë po zvogëlohet në emër të zhvillimit të bizneseve, ndërsa shpesh kemi raste vetëm të degradimit të tokës së bukës dhe mos zhvillim ekonomik në këto ngastra.

Vendimi për rishikimin e buxhetit për vitin 2012 ka sjellë vendime kontradiktore nisur nga faktet se janë bërë ndryshime ad hoc në projekte të caktuara. INPO konsideron se këto ndryshime përkundër nevojave të rishikimit të buxhetit nuk duhet të vijnë nga zyrat e mbyllura por ato duhet të përcillen me një transparencë të lartë dhe më një arsyeshmëri të fuqishme. INPO edhe publikisht ka shprehur kundërshtimet e saj për heqjen me rishikim të projekteve për ndërtimin e zyrave të vendit në Gaçkë dhe Greme.

Edhe në muajin qershor kemi pasur një vendim për rritjen e të hyrave vetanake të vitit fiskal 2012. Me këtë vendim miratohet rritja e të hyrave vatanake të vitit fiskal 2012 në vlerë prej 400.000 euro. INPO konsideron se planifikimi i të hyrave vetanake nuk mund të bëhet nga një etapë në tjetrën por ato duhet të bëhet me planifikim të qëndrueshëm e jo me politika për nevoja të ngushta.

FUNKSIONIMI I KPF-SË

Komiteti për politikë dhe financa kryesohet nga kryesuesi i kuvendit të komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në kuvendi i komunës.

Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifrat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.¹⁷

Edhe KPF nuk ka arrit të kryej funksionin vet si duhet pasi që gjatë fushatës ka pauzuar. INPO ka vërejt se ky pauzim ka qenë i panevojshëm dhe krejtësisht i dëmshëm, sepse përkundër mungesës së kryetarit, KPF-ja dhe KK-ja kanë mundur t'i kryejnë punët e tyre dhe të mos vije deri te një stagnim institucional. Po ashtu për shkak të kalimit të anëtarit të këtij Komiteti nga radhët e LDK-së, Avdullah Hoxhës në radhët e PDK-së, nuk janë gjetur dhe as shfrytëzuar rrugët ligjore për zëvendësimin dhe kompletimin sa më të shpejt të Komitetit me anëtar të ri. Gjatë kësaj kohe janë marrë shumë vendime në KPF me një mbizotërim të plotë të pozitës, andaj INPO konsideron se procedurat e zëvendësimit të një anëtarit të Komitetit të jenë më të thjeshta dhe më të drejtpërdrejta sesa proceduarat në fillim të themelimit të Komitetit. Në këtë rast faj ka edhe vet grupi parlamentar i LDK-së i cili nuk ka shfrytëzuar të gjitha rrugët procedurale me kohë për të propozuar kandidatin e tyre dhe kështu po mbushen më se tre muaj që LDK-ja është pa përfaqësues në këtë Komitet, ndërsa as zv/kryesuesi Ramadan Hasani nuk ka qenë vigjilent për të kërkuar një gjë të tillë me kohë.

Në anën tjetër INPO mendon se KPF-ja, përkundër rolit të tij të njohur edhe me ligj, mbizotëron punën e kuvendit, dhe shpesh këshilltarët dhe as qytetarët nuk e kanë të qartë plotësisht se çfarë është vendosur në Komitet për një çështje, për më keq nuk e kanë të qartë rrjedhën dhe qëllimin e plotë të një çështjeje. Andaj do të ishte në funksion të një transparence më të madhe që së paku anëtarëve të KK-së të ju jepej nga një kopje procesverbalit para seancave dhe ata të kishin mundësi të shohin se si kanë rrjedhur diskutimet në KPF, kush çka ka propozuar dhe kush çka ka mbrojtur.

¹⁷ Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, neni 52

MARRDHËNIET E EKZEKUTIVIT ME LEGJISLATIVIN

Marrëdhëniet në mes të ekzekutivit dhe të legjislativit na japin më së mirë parametrin më real të funksionimit demokratik të këtyre institucioneve qeverisëse. Mirëpo sa do që ky raport është delikat si në mbarë vendin edhe në komunën tonë ende mbetet shumë për tu dëshiruar që ky raport të jetë harmonik dhe kreativ. Shikuar funksionimin kuvendit komunal nga prizmi i këtyre raporteve INPO konstaton se ende kuvendi shikohet vetëm si vendi ku duhet ngritur gishtat për çështjet që propozon ekzekutivi dhe jo si vendi ku edhe të lindin politikat. Roli i këshilltarëve komunal është rrudhur deri në masën që ata nuk janë më subjekt krijues, aktiv por për më shumë janë objekte dhe numra. Po thuaj asnjë nga rregulloret dhe pikat e rendit nuk propozohen nga këshilltarët por vetëm nga KPF-ja e cila punon në ndikimin e drejtorive dhe të kryetarit.

Sipas INPO-s kjo gjë vije edhe si rezultat i “uzurpimit” të ndikimit nga ana e drejtorive dhe marrja e rolit të plotë në duart e tyre të qeverisjes, duke mos lejuar që qeverisja të shtrihet deri tek këshilltarët dhe pastaj nëpërmjet tyre deri tek qytetarët. Këtu fillon edhe deformimi i proceseve demokratike. As një drejtori nuk ka dalë para këshilltarëve të kërkon ide fillestare për një çështje, por para këshilltarëve sillen dokumentet e formësuara dhe ata pastaj vetëm për detaje dhe ndryshime kozmetike mund të flasin apo të diskutojnë derisa t’i ngritin gishtat për votim. INPO konsideron se gradualisht ky raport duhet të ndryshohet dhe drejtoritë duhet të fillojnë të komunikojnë ndryshe me këshilltarët. INPO në disa raste ka vërejt edhe mungesat e theksuara të ish- kryetarit Xhemajli dhe të nënkryetarit Zymeri të cilët nuk kanë marrë pjesë fare më seancat e KK-së, ka pas raste kur as disa drejtorë nuk kanë çdo herë të pranishëm gjatë zhvillimit të punimeve të KK-së. Kjo gjë ka zbehur punën e KK-së dhe shpesh i ka shndërruar seancat në një makinë fotokopjeje të vendimeve.

Mirëpo në anën tjetër nuk mbesin pa përgjegjësi as këshilltarët, posaçërisht ata të opozitës të cilët nuk janë mjaft aktiv në kuadër të natyrës së tyre opozitare për të ngritur çështje dhe për ta sjell ekzekutivin para situatave kritike. Gjatë kësaj periudhe nuk është shënuar asnjë kërkesë për interpelancë, ku ndonjëri prej drejtorëve do të duhej të përgjigjej për ndonjë çështje të ngritur. Për më keq as sistemi i pyetjeve të këshilltarëve dhe pika e rendit nën të ndryshme nuk e kanë marrë peshën e tyre pikërisht për shkak të këtij raporti jo dinamik në mes të ekzekutivit dhe të legjislativit. Tek këshilltarët është krijuar bindja se si pyete si nuk pyete është krejt njëllë, kurse çështje e ngritur nën të ndryshme përfundojnë po në atë seancë vetëm si çështje të deklaruara dhe nuk zhvillohen pastaj. INPO konsideron se kjo është detyrë e kryetarit të ri që t’i përmirëson këto marrëdhënie në funksion të demokratizimit të procesit të vendimmarrjes edhe të promovimit të vlerave të krijimit të urave institucionale të bashkëveprimit.

NDËRMARRJET PUBLIKE KOMUNALE

INPO ka monitoruar edhe punën e ndërmarrjeve publike “Pastërtia” dhe “Bifurkacioni” duke përcjell nga afër zhvillimet brenda tyre.

INPO ka përcjell me shumë kujdes shpalljen e konkursit dhe procesin e intervistimit për 28 vende të lira pune në KRM “Pastërtia”.

Profilet e të cilat kërkohen të plotësohen në këtë kompani kanë qenë që nga pastruesit e rrugëve, roja objektivësh e deri te inkasantë të borxheve.

Në KRM “Pastërtia” ky ishte konkursi i parë që organizohej ngase asnjëherë nuk është shpallur konkurs për punësim. INPO shpreh dyshimet se ky konkurs është shpallur dhe organizuar vetëm formalisht, sepse shumica e aplikantëve për këto vende të lira të punës, tashmë ishin në marrëdhënie pune me KRM “Pastërtia”, mirëpo pa kontrata valide të punës.

INPO ka monitoruar procesin e intervistimit të kandidateve dhe ka vërejtur parregullsi të ndryshme. E para, komisioni intervistues nuk ka qenë serioz dhe forma e intervistimit nuk ka qenë përmbajtësore, për të mos thënë sa për sy e faqe. Pothuajse asnjë pyetje nga ana e anëtarëve të komisionit nuk ka qenë direkt e lidhur me natyrën e punës të profileve të shpallura, bile ka pasur momente kur anëtarët e komisionit i kanë thënë të intervistuarit “ti veç i din këto pune sepse ke punu”, çka është një dëshmi e qartë për mos seriozitetin e këtij konkursi.

Gjithashtu, kemi vërejtur se shumica e aplikantëve i janë nënshtruar intervistimit me uniformë të punës, çka do të thotë se ata gjatë orarit të punës kanë ardhur që të intervistohen. Për mendimin tonë, ky konkurs është vetëm një kamuflim i KRM “Pastërtia” sepse pozitat tashmë janë të plotësuara dhe përmes këtij konkursi ato vetëm do të legjitimohen.

INPO i bënë thirrje organeve komunale dhe KRM “Pastërtia” që të mos keqpërdorin institucionin e konkursit për të legjitimuar punëtorët e punësuar në mënyrë të parregullt. Konkursët duhet të jenë një mundësi e barabartë për të gjithë qytetarët pa dallim që të konkurrojnë për vende të punës e jo një mekanizëm manipulimi për punësime të paligjshme që bëhen në institucione publike.

Një vëmendje INPO i ka kushtuar edhe ankesave të qytetarëve nga zonat rurale ku përkundër investime të mëdha në sistemet e ujësjellësit me anë të shpimeve të puseve, shuma nga fshatra nuk kanë ujë kohë pas kohe apo fare. INPO konsideron si tepër të vonuar sqarimin kompetencave në mes të komunës dhe NP “Bifurkacioni” rreth nënshkrimit të një memorandumit për përcaktimin sa më të qartë të kompetencave për mirëmbajtjen e këtyre ujësjellësve, sepse donatori dhe implemtuesi i këtyre ujësjellësve përfundon mbikëqyrjen me kryerjen punimeve.

Një kaptinë e veçantë e raportit të komunës me ndërmarrjet publike ka qenë ajo gjatë fazës emergjente të ditëve të dimrit ku konsiderojmë se KRM “Pastërtia” ka dështuar për të qenë në

nivel të detyrës kurse komuna është vonuar për të ndërhy tek kjo kompani për t'i kryer si duhet obligimet e veta. Shih për këtë komuna është dashtë të angazhoj forca nga jashtë për të përballuar sadopak vështirësitë që ka nxjerr rënia madhe e borës. INPO konsideron se sado që këto situta mund të vijnë befasisht pushteti lokal është dashtë t'i parasheh ato dhe të ketë plane operative të gatshme dhe mos të pret që vetëm kur të bllokohen fshatrat atëherë të ndërhyjë. Mirëpo se niveli i përgjegjësisë së KRM "Pastërtia" nuk ka qenë në nivel tregon edhe fakti se as trotuaret në rrugët qendrore të qytetit nuk janë pastruar me kohë duke lejuar që ato të bëhen të pakalueshme për qytetarët.

10. ZHVILLIMI URBAN NË KOMUNËN E FERIZAJT

Tek Drejtoria për urbanizëm gjeodezi dhe kadastër ushtrimi i veprimtarisë ka karakter në bazë të planeve vjetore dhe në raste të caktuara edhe me plane më afatgjate p.sh për realizimin e ndonjë projekti siç është plani urbanistik deri në finalizimin e projektit nevojitet 3 deri në 4 vite.

Sfidat kryesore që kanë penguar realizimin e punës së drejtorisë sipas drejtoreshës Vata kanë qenë problemet me alokimin e buxhetit për shkak të vonesave deri në muajin mars. Kjo gjë i ka pamundësuar drejtorisë që të shpallin projektet për derisa nuk i kanë pasur në dispozicion shumat e parave që nevojiten për realizimin e projekteve. Gjithashtu pengesë tjetër për punën e drejtorisë janë procedurat e prokurimit të parapara me ligj, që aludojnë çdo herë në ofertuesin më të lirë e që bien ndesh me synimet e drejtorisë për punë kualitative, jo çdo herë më i liri.

Kjo drejtori është në fazën e hartimit të planeve zhvillimore nëpër zona. Tashmë plani zhvillimor për 2 zonat urbane në Ferizaj është miratuar nga kuvendi, 4 zona urbane janë në proces dhe 2 të tjera mbeten për në të ardhmen. Edhe pse janë bërë shumë përpjekje për organizimin e debateve me qytetarë brenda lagjeve të zonave, këto debate kryesisht kanë dështuar. INPO ngre shqetësimin për dështimin e këtyre debateve, sepse kjo gjë sikur reflekton edhe dyshimin në mundësinë e realizimit të planeve të miratuara. Mosardhja e qytetarëve sikur flet për një refuzim, qoftë për shkak të uzurpimeve nga ana e tyre apo edhe nga mungesa e ofrimit të një komunikimi më të mirë nga komuna. Gjithashtu Ferizaj është komuna e parë në Kosovë që po promovon një plan urban në zonat rurale, konkretisht në fshatin Softaj (duke pasur parasysh migrimin e madh të fshatit në qytetin e Ferizajt për kryerjen e shërbimeve). Është organizuar një debat me gratë e fshatit Softaj (ka dështuar, edhe pse njoftimet, informatat janë shpërndarë me kohë) pritet që debate të organizohet edhe një herë gjatë muajit shtator, për të marr inpute nga gratë e fshatit pasi konsiderohen si grup i marginalizuar. Krijimi i zonave sekondare ashtu siç janë të parapara edhe me planin zhvillimor komunal dhe atë urban është gjë e mirë nga ana e komunës, por me këtë rast INPO e çmon rolin e zyrës së UN-Habitatit e cila në diaspora raste është promotore e këtyre realizimeve, më parë se vet komuna. Andaj është mirë nga Drejtoria e urbanizimit që shpesh të mos pres ndërhyrjen e UN-Habitatit për të realizuar projekte të natyrës si tek Ura e Dudit, projekti për Softajt apo i "korridoreve të gjelbra".

Sa i përket stafit që punon në drejtorinë e urbanizmit drejtoresha është shprehur se stafi nuk është i mjaftueshëm, p.sh në kuadër të drejtorisë vepron vetëm një zyrtar për mbrojtjen e mjedisit, duke pasur parasysh vëllimin e punëve qe ka kjo drejtori si: takimet me qytetar, këshillin e ekspertëve që të gjitha këto takime është dashur të mbahen jashtë orarit të punës, pasi që brenda orarit ka qenë e pa mundur. Përndryshe stafi aktual është i kualifikuar dhe me përvojë në këtë lëmi. Në ndërlidhje me këtë INPO kërkon nga komuna dhe Drejtoria që të mos lejoj asnjë plan të realizohet pa e dhënë mendimin edhe ekspertët komunal, posaçërisht në këtë rast tërheqim vërejtjet me “eksperimentet” që janë kryer tek bifurkacioni në përpjekje për të realizuar një projekt të financuar nga KE-ja.

Veprimtaria e drejtorisë synon të jetë transparente, drejtoria raporton në mënyrë të rregullt te kryetari i komunës (3 mujorësh, 6 mujorësh), të gjitha veprimet dhe aktivitetet e drejtorisë publikohen në ueb-faqen e komunës, ka raste kur publikohen edhe përmes mediave. Kurse të gjitha aktivitetet e drejtorisë janë të formës së shkruar (leje, dosje, kërkesa) dhe këto dokumente arkivohen (jo nga drejtoria) dhe çdo kush ka të drejtë që të kërkoj qasje në këto dokumente. Janë mjaftë të shpeshta rastet kur AKP kërkon qasje në këto dosje dhe drejtoria çdo herë i është përgjigjur pozitivisht. Mirëpo INPO në përputhje edhe me kërkesat vazhdueshme të zyrës së auditorit gjeneral, kërkon që kjo drejtori të bëjë shënimin e pasurisë së plotë të komunës si dhe të bëjë publike të gjitha uzurpimet që janë bërë deri më tash. Kjo gjë prej viti në vit zvarritet dhe kjo lë shumë për të dëshiruar në vullnetin për transparencë.

Rritja e taksave për ndërtim ka ngjallur shqetësim të madh për INPO. Në këtë drejtim ka pasë edhe ankesa të mëdha të qytetarëve. Edhe pse sipas , drejtoreshës Vata taksat nuk janë të larta nëse krahasojmë vlerën e taksave me komunat e rajonit, INPO kërkon që të bëhet një analizë e hollësishme se sa këto taksa e kanë dëmtuar zhvillimin e qytetit dhe një raport i tillë të paraqitet në kuvend. Në anën tjetër Drejtoria ka theksuar se Ferizaj është komuna e tretë në Kosovë për nga vlera e buxhetit dhe se numri i ndërtimeve në Ferizaj është shumë i lart dhe vlera e taksave nuk ka korresponduar me madhësinë e buxhetit. Kështu që sipas drejtoreshës vlera e taksave mbi ndërtimin në komunën e Ferizajt nuk është e lartë pasi që përcaktohet varësisht nga në vlera e investimit. Sidoqoftë për të pasur një pasqyrë më të qartë, qytetarëve duhet t’iu ofrohet një analizë e plotë rreth pasqyrimit të taksave në ritmin e ndërtimit. INPO konsideron se krahasuar me vitet paraprake është ndalë hovi i ndërtimeve në Ferizaj dhe asnjë përfitim nga rritja e taksave nuk e arsyeton ngecjen e zhvillimit.

11. ARSIMI

Komunat kanë kompetenca të plota sa i përket ofrimit të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm të ultë, përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve shkollore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e mësuesve dhe administratës së arsimit, në përputhje me interesat e komunës dhe me standardet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Komuna e Ferizajt për vitin 2012 ka ndarë shumë prej 9,212,370.5 milionë euro për Drejtorinë e Arsimit. Këto mjete janë ndarë për të gjitha kategoritë e shpenzimeve sa i përket shpenzimeve të fushës së arsimit. Komuna e Ferizajt edhe më tej i kushton rëndësi të madhe investimeve kapitale ku për vitin 2012 për investime kapitale janë ndarë 584,402.0 mijë euro. Për paga dhe medijtje janë ndarë 7,969,418.5 milionë euro dhe për subvencione kjo drejtori ka ndarë 90,000.0 mijë euro.

Në drejtorinë e arsimit për gjashtëmuorin e parë të vitit ishin paraparë 11 projekte, 4 në përgatitje për tenderim dhe 7 në implementim. Sipas drejtorit Agim Berisha vonesat e përgatitjes së projekteve kanë ardhur nga firmat kontraktuale, mirëpo kjo drejtori nuk i përgatit projektet, ajo vetëm i inicion për prokurim projektet. Për një për mirëvajtje më të mirë në realizimin e projekteve drejtori Berisha thekson nevojën për një arkitekt dhe inxhinier në kuadër të kësaj drejtorie e cila pritet të plotësohet.

Përkundër investimeve të mëdha nëpër objektet shkollore dhe krijimit të hapësirës mësimore INPO kërkon nga kjo drejtori që t'i shtoj kërkesat për kryerjen e punimeve në mënyrë sa më profesionale, sepse ka raste kur shkollat e posa ndërtuara fillojnë të shkatërrohen. INPO ka përcjellë me kujdes edhe cilësinë e mësimin dhe angazhohet që të punohet më shumë në rritjen e mëtutjeshme. Edhe pse rezultati i testit të maturës ka shënuar një rritje të ndjeshme, INPO kërkon që të ketë me shumë punë profesionale nëpër shkollat profesionale, si në atë teknike dhe në atë të bujqësisë, të cilat vazhdojnë të mos kenë sukses në punë e tyre.

INPO ka përcjell me shqetësim edhe faktin që një profesor në gjimnazin “Kuvendi i Arbërit” është zënë në flagrancë duke shitur nota. Edhe pse duam të jemi larg paragjyqimit ky rast duhet të jetë një sinjal alarmi për Drejtorinë që të bëjë analiza më të thella se si është e mundur kjo gjë të ndodh para syve të të gjithëve dhe se a është rast i izoluar ky apo, vetëm njeri nga të tjerët. INPO ka parë si vullnet të mirë të drejtorit Berisha disa masa administrative të publikuara në shtyp, në lidhje me rritjen e disiplinës si nga e nxënësve ashtu edhe nga ana e mësimeve, por INPO mendon se para masave administrative drejtoria duhet të kërkon përgjegjësi nga drejtorët e shkollave dhe të fillojë të bëjë de - politizimin e arsimit.

TESTI KOMBËTAR DHE CILËSIA E TIJ

Këtë vit testin kombëtar të maturës e kanë kaluar 48.19 për qind e nxënësve të shkollave të mesme, ndërsa në vitin e kaluar përqindja ka qenë mjaft e vogël dhe këtë test e kishin kaluar vetëm 34.34 për qind.

Gjimnazi “Kuvendi i Arbërit” ka arritur rezultat prej 66.19 për qind e nxënësve, edhe pse këtë vit me një rënie të vogël në krahasim me vitin e kaluar mbetet shkolla me kalueshmërinë më të madhe nga të gjitha shkollat e mesme të komunës. Shkolla e mesme e bujqësisë “Zenel Hajdine” edhe pse këtë vit pati një rritje të kënaqshme të kalueshmërisë prapë mbetet shkolla me suksesin më të dobët në testin e maturës. Kjo tregon se në këtë shkollë duhet të bëhen reforma esenciale nga vet drejtoria dhe shkollës dhe nga drejtoria komunale e arsimit.

INPO e sheh si shqetësuese faktin se pas publikimit të rezultateve të testit të maturës drejtoria komunale për arsim nuk interesohet më se sa është numri i maturanteve ferizajas që pas shkollës mesme vendosin me i ndjek studimet universitare. INPO sugjeron drejtorinë komunale për arsim që të interesohet për maurantët që regjistrohen në fakultete dhe kështu të ketë një pasqyrim se në cilat fusha po kanë të rinjtë tanë më tepër interesim të studiojnë dhe në këtë mënyrë pak a shumë të kuptohet edhe ajo që do e pres tregun e punës në qytetin e Ferizajt.

TESTI I ARRITSHMËRISË

Nxënësit në përfundim të shkollës së mesme të ulët respektivisht nxënësit e klasave të nënta iu nënshtruan testit të arritshmërisë. Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj, ka shpallur rezultatet e testit të arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta të mbajtur me 3 korrik të këtij viti, sipas të cilave arritshmëria është 52.28 për qind. INPO këtë rezultat të përgjysmuar të kalueshmërisë së nxënësve të shkollave fillore e sheh si brengosës sepse nga ky rezultat pritet që në shkollë të mesme këta nxënës të mos arrijnë ta nxëjnë planpragramin e paraparë për shkollarë të mesëm. Për këtë arsye kërkohet angazhim më i madh për të rritur cilësinë në shkollat fillore nga të gjithë përgjegjësit.

ÇERDHET

Edukimi parashkollorë është hallkë përbërëse e një sistemi unik të edukimit në Kosovë dhe nëpërmjet monitorimit, INPO ka nxjerr në pah edhe një parregullsi të këtij institucioni. Si i tillë institucioni i vetëm parashkollorë publik në Ferizaj nuk përmbush qëllimin e inkuadrimin të të gjithë fëmijëve dhe inkurajimit të tyre që të kuptojnë dhe të pranojnë vetveten, të pranojnë ndryshimet dhe të tjerët. Ky institucion edhe këtë vit vazhdon t'i diskriminoj dhe të mos pranoj

fëmijë me aftësi të kufizuara duke rënë ndesh në mënyrë të drejtpërdrejtë me nenin 6 të ligjit për edukim parashkollor, i cili thotë: “Edukimi parashkollorë është e drejtë e të gjithë fëmijëve përfshirë këtu edhe ata me nevoja të veçanta”. INPO këtë diskriminim e sheh si shumë alarmues për të gjitha organet kompetente për këtë çështje.

Lidhur me investimet ne çerdhet, INPO shpreh shqetësimin e saj për renovimin që është bërë në çerdhen e fëmijëve në Lagjen të Re, objekt ky i cili është vonuar të shfrytëzohet si dhe ka pasur tentativa që të demolohet nga huliganët. E gjithë kjo vërejtje si pasojë e reagimit të vonuar të drejtorisë së arsimit për shfrytëzim dhe mirëmbajtje të objektit.

KULTURA

Në drejtorinë për kulturë rini dhe sport, riorganizimi i grupeve artistike, si ansambli “Kastriotët”, klubi letrar “De Rada”, shoqatës së artistëve figurativë “Zef Kolombi” etj, kanë qenë preokupimet në fillim të këtij viti. Manifestimet për përvjetorin e pavarësisë së Kosovës, kanë qenë më tipiket gjatë muajit shkurt, kurse më pas kanë qenë manifestimet kulturore me rastin e 7-8 marsit, e cila është përcjellë edhe një ekspozitë të grave piktoreske. INPO çmon angazhimin e artistëve për mbajtje gjallë të jetës kulturore, por INPO kërkon nga Drejtoria që të mos lejojë që këto manifestime të degradohen në manifestime amatore dhe folklorike dhe të mbesin larg shënimit të vlerave të mirëfillta artistike.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme mbase janë reflektuar edhe në këtë drejtori pasi që drejtori i saj, ishte kandidat për kryetar. Zëvendësimi i drejtorit të vjetër me drejtor të ri sikur ka lënë gjurmë në atmosferën brenda kësaj Drejtorie. INPO nuk e ka pa me sy të mirë përpjekjet për politikë brenda kësaj drejtorie gjatë fushatës elektorale, ku ka pasë rreshtime të hapura qoftë të grupit të rinjve apo edhe të zyrtarëve të lartë të cilët gjatë fushatës janë shndërruar në zëdhënës të shtabeve zgjedhore të partive politike.

“Ditët e kulturës 2012” në Ferizaj tashmë janë bërë tradicionale. Gjatë këtyre ditëve jepen manifestime të shumta duke filluar që promovimi i librave, dhënia e dokumentarëve, hapja e ekspozitave, promovimi të trashëgimisë kulturore, etj., mirëpo INPO kërkon që përgatitjet për këto manifestime të mos bëhen ad hoc dhe të mos ketë improvizime të rasteve. Shpesh pjesëmarrja e publikut është mospërfillëse, andaj INPO kërkon që të bëhet një marketing më i qëndrueshëm kulturor për të sensibilizuar komunitetin e artistëve.

12. REKOMANDIMET

7. Rekomandojmë që pushteti lokal të krijojë plane operative për situatat urgjente; vonesën e aprovimit të buxheti; situatat emergjente të shkaktuara nga natyra si dhe gjatë zgjedhjeve të imponuara të jashtëzakonshme.
8. INPO ka konstatuar rënien e performancës qeverisjes gjatë zgjedhjeve andaj rekomandon që me kusht që të mos përsëriten këto dobësi që qeveria lokale të mbetet sa më larg këtyre zhvillimeve dhe të vazhdon t'i përmbush detyrat e saj ligjore.
9. Rekomandohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa që ndryshimet që prekin rrjedhat buxhetore të mos i bëjë në procedurë ad – hoc por ajo të jetë pjesë e strategjive buxhetore afatgjata dhe pjesë e komunikimeve të gjera.
10. Raportet mes Ekzekutivit dhe Legjislativit rekomandohet të marrin kualitet të ri ku duhet të fuqizohet roli i Kuvendit dhe i Këshilltarëve komunal.
11. Rekomandojmë që Drejtoria e Arsimit të bëjë analizë dinamike të suksesit të maturantëve ferizajas në procesin e regjistrimit në fakultete dhe nga aty për nxjerr rekomandime për avancimin procesit arsimor në komunën tonë
12. Mbetet detyrë e përhershme e komunës të fuqizojë ndikimin e vet te ndërmarrjet publike për t'i përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve.



National Endowment *for* Democracy
Supporting freedom around the world

**PROJEKTI I MONITORIMIT TË KOMUNËS SË FERIZAJT DHE
PUBLIKIMI I KËTIJ RAPORTI ËSHTË PËRHRAHUR NGA: NATIONAL
ENDOWMENT FOR DEMOCRACY - NED**

INICIATIVA PËR PROGRES - INPO
RR: "AHMET KAÇIKU" 35/KATI 5 | FERIZAJ, 70000 KOSOVË
TEL: +381 (0) 290 329 400 | +377 (0) 44 746 749
WWW.INPO-KS.ORG | E-MAIL: INFO@INPO-KS.ORG